



Pranimi / Dostizmat Prenjeve/Predata Received/Drizmaty	10 - 10	2022	2	viti god year
Organizata Organizacija Org. Unit	Nr. Pror. Dr. Pror. Pror. No.	Shtypja e Prilog. Appendix	Sasia Kolicema Quantity	
SKM/SICK	6050/2022		1/13	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.184/2020

Këshilli i Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari- dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, duke vepruar sipas Aktgjykimit me numër A.nr.1994/22, të datës 06.09.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.184/2020 të datës 10.07.2020 të parashtruar nga grup ankuesish:

në emër të ankuesit të cilët me autorizim tani i përfaqëson, përfaqësuesi i grupit të ankuesve me adresë banimi Komunën e Podujevës, kundër organit të punësimit/Komuna e Podujevës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, 1.6 dhe 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 10.10.2022, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.184/2020 të datës 10.07.2020 të parashtruar nga ankuesit.**

**II. APROVOHET** si e bazuar ankesa me numër A.nr.184/2020 e datës 10.07.2020 e parashtruar nga ankuesit :

të cilët

me autorizim i përfaqëson ndërsa lënda kthehet në *Rishqyrtim dhe Rivendosje* në Njësinë e Burimeve Njerëzore të Komunës së Podujevës.

**III. SHFUQIZOHET** Vendimi me numër Nr.Prot.13-104/03-00330068/20 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Podujevës i datës të datës 02.07.2020.

**IV. OBLIGOHET** Kryetari i Komunës së Podujevës që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës,** duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.



## A r s y e t i m

Ankuesit si në pikën I dhe II të dispozitivit, fillimisht me datën 16.01.2020, përmes kryetarit të shoqatës sindikale kanë parashtruar kërkesë për pagesën e beneficioneve të punëtorëve të komunës tek Njësia e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Podujevës, ndërsa me datën 30.01.2020 përmes shkresës së nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Drejtori i Drejtorisë së Administratës Komunale dhe menaxheri i Njesisë së Burimeve Njerëzore i janë përgjigjur përfaqësuesit të palëve, ndërsa në pikën 4. *“kërkesa të tjera”* të përgjigjes në fjalë përcaktohet se, citoj: *“të gjitha të drejtat ligjore të të punësuarve do të respektohen dhe procedohen sipas afatit ligjor. (Zyra e personelit të zbatojë këtë pikë)”*, mirëpo pas kësaj shkrese më nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim tjetër procedural nga ana e institucioneve të Komunës së Podujevës.

Me datën 22.06.2020, ankuesit përmes përfaqësuesit të tyre me autorizim, kanë parashtruar ankese tek Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe ankesave të Komunës së Podujevës lidhur me kompensimin material, për pagesën e pagës së 13 për çdo vit kalendarik në vlerën e pagës baze, pagën përcjellëse me rastin e pensionimit në lartësi të tri pagave mujore, pagesën për shpërblimin jubilar si dhe pagesën për ushqim ditor për ditët e pranisë në punë. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Podujevës, me datën 02.07.2020, ka nxjerrë Vendimin Nr.Prot.13-104/03-00330068/20 sipas të cilit e ka refuzuar ankesën e ankuesve, me arsyetimin se për shkak të komplikimeve buxhetore në këtë institucion nuk ka mund të gjej zbatueshmërinë.

Te pakënaqur me vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Podujevës, me datën 10.07.2020, kanë parashtruar ankesën me numër të protokollit 1343/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensim lidhur me pagesën e pagës së 13 për çdo vit kalendarik në vlerën e pagës bazë, pagat përcjellëse me rastin e pensionimit në lartësi të tri pagave mujore, pagesën për shpërblimin jubilar si dhe pagesën për ushqim ditor për ditët e pranisë në punë sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të vitit 2015.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 15.07.2020, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesve në Komunën e Podujevës. Me datën 11.08.2020 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Podujevës me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 20.08.2020 përmes Njoftimit me Nr.Prot:1590/2020, ka njoftuar përfaqësuesin e ankuesve se nuk mund të vendos lidhur me ankesën A.nr.184/2020 të datës 10.07.2020, për shkak se Këshilli nuk është funksional, duke i udhëzuar të njëjtit mbi të drejtën e inicimit të procedurës gjyqësore në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.



Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datën 06.09.2022 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.1994/2022, i cili në Këshill është pranuar me datën 09.09.2022, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve, duke anuluar njoftimin e datës 20.08.2020 të KPMSHCK-se dhe ka obliguar Këshillin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e ankuesve me numër A.nr.184/2020 të datës 10.07.2020.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:** Ankesën me Nr.Prot:1343/2020 të datës 10.07.2020 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 05.02.2020 nga përfaqësuesi ligjor i ankuesve; Kërkesën e datës 14.01.2020 për kompensim material e parashtruar tek Komuna e Podujevës nga Kryetari i Shoqatës Sindikale për ankuesit; Përgjigjen e datës 30.01.2020 nga organi i punësimit komfor kërkesës së ankuesve; Ankesën e ankuesve të datës 22.06.2020 e parashtruar nga përfaqësuesi ligjor i ankuesve tek Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin Nr.Prot.13-104/03-0033068/20 të datës 02.07.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Listën e pagave për muajin qershor të vitit 2020; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 15.07.2020 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen e datës 11.08.2020 nga Komuna e Podujevës lidhur me provat e bashkangjitura të lendes; Akt emërimit e ankuesit N.T i të datës 03.01.2018; Akt emërimit e ankueses Sh. F të datës 01.04.2014; Akt emërimit e ankuesit F. H të datës 03.01.2014; Akt emërimit e ankuesit M.H të datës 05.01.2017; Akt emërimit e ankuesit A.B të datës 26.02.2019; Akt emërimit e ankuesit V. Sh të datës 01.06.2013; Akt emërimit e ankueses J.M të datës 01.04.2014; Akt emërimit e ankueses Sh. M të datës 01.04.2014; Akt emërimit e ankuesit I. G të datës 01.08.2017; Akt emërimit e ankuesit A.Sh të datës 21.09.2018; Akt emërimit e ankueses Sh.A të datës 05.01.2015; Akt emërimit e ankueses F. S të datës 01.08.2019; Akt emërimit e ankueses S.V të datës 01.04.2017; Akt emërimit e ankuesit E.B të datës 01.02.2013; Akt emërimit e ankuesit H.H të datës 03.01.2018; Akt emërimit e ankueses E.T të datës 05.01.2016; Akt emërimit e ankueses H. Gj të datës 29.02.2014; Akt emërimit e ankueses Xh. Zh të datës 05.01.2015; Akt emërimit e ankueses N. A të datës 01.04.2015; Akt emërimit e ankuesit G. H të datës 19.11.2019; Akt emërimit e ankueses Sh.M të datës 03.06.2019; Akt emërimit e ankueses A. H të datës 05.01.2017; Akt emërimit e ankuesit A.J të datës 01.06.2018; Akt emërimit e ankueses J. Sh të datës 01.07.2019; Akt emërimit e ankueses K.A të datës 05.01.2012; Akt emërimit e ankueses H.A të datës 01.02.2013; Akt emërimit e ankuesit E.F të datës 03.01.2015; Akt emërimit e ankuesit A. K të datës 01.03.2014; Akt emërimit e ankuesit B. D të datës 05.01.2016; Akt emërimit e ankuesit N.I të datës 20.02.2012; Akt emërimit e ankuesit I.K të datës 05.01.2012; Akt emërimit e ankuesit S.P të datës 05.01.2015; Akt emërimit e ankuesit L.K të datës 03.01.2014; Akt emërimit e ankuesit S.R të datës 01.04.2019; Akt emërimit e ankuesit M.G të datës 01.03.2019; Akt emërimit e ankuesit B.D të datës 01.04.2017; Akt emërimit e ankuesit A.M të datës 01.02.2019; Akt emërimit e ankueses Shkurte M.F të datës 01.04.2015; Akt emërimit e ankuesit A.A të datës 01.04.2015; Akt emërimit e ankuesit B.N të datës 01.02.2013; Akt emërimit e ankuesit A.U të datës 03.01.2019; Akt emërimit e ankueses F.H të datës



05.01.2015; Akt emërimin e ankueses V.P te datës 01.02.2017; Akt emërimin e ankueses S.K te datës 01.01.2012; Akt emërimin e ankuesit S.A te datës 01.10.2015; Kontratën e punës për kohë të caktuar/pacaktuar të datës 05.01.2018 për ankuesin A.M; Kontratën e punës për kohë të caktuar/pacaktuar të datës 04.01.2016 për ankuesin I.M ; Kontratën e punës për kohë të caktuar/pacaktuar të datës 05.01.2018 për ankuesin I/M; Kontratën e punës për kohë të caktuar/pacaktuar të datës 03.01.2018 për ankuesin A.H; Akt emërimin e ankuesit Sh.B te datës 05.01.2017; Akt emërimin e ankuesit S.H te datës 01.10.2015; Akt emërimin e ankuesit L.M te datës 01.04.2014; Akt emërimin e ankuesit F.G te datës 05.01.2017; Akt emërimin e ankuesit F.A te datës 01.04.2014; Akt emërimin e ankuesit V.B te datës 03.01.2011; Akt emërimin e ankuesit I.R te datës 05.01.2017; Akt emërimin e ankuesit S.M te datës 01.02.2017; Akt emërimin e ankuesit K.M te datës 16.11.2019; Akt emërimin e ankuesit A.M te datës 01.08.2013; Akt emërimin e ankuesit Sh.M te datës 01.06.2019; Akt emërimin e ankueses A.D te datës 01.06.2019; Akt emërimin e ankueses N.A te datës 01.04.2014; Akt emërimin e ankueses B.P te datës 13.12.2013; Akt emërimin e ankueses N.M te datës 01.04.2014; Akt emërimin e ankuesit Sh.M te datës 05.01.2017; Akt emërimin e ankueses S.ZH te datës 05.01.2015; Akt emërimin e ankuesit V.C te datës 01.08.2019; Akt emërimin e ankueses M.N te datës 21.06.2018; Akt emërimin e ankueses M.H te datës 01.06.2016; Akt emërimin e ankuesit F.T te datës 01.04.2014; Akt emërimin e ankuesit B.A te datës 01.02.2019; Akt emërimin e ankuesit R.L te datës 01.04.2014; Akt emërimin e ankueses M.S te datës 01.07.2019; Akt emërimin e ankueses F.K te datës 03.01.2012; Akt emërimin e ankuesit I.H te datës 01.04.2014; Akt emërimin e ankuesit B.H te datës 03.01.2015; Kontratën e punës për kohë të caktuar/pacaktuar të datës 03.01.2019 për ankuesin H.Rr; Akt emërimin e ankuesit S.R te datës 05.01.2017; Akt emërimin e ankuesit K.ZH te datës 05.01.2012; Akt emërimin e ankuesit I.H te datës 10.04.2018; Akt emërimin e ankuesit R.H 03.01.2016; Kontratën e punës për kohë të caktuar/pacaktuar të datës për ankuesen V.B; Kontratën e punës për kohë të caktuar/pacaktuar të datës 05.01.2018 për ankuesin F.N; Kontratën e punës për kohë të caktuar/pacaktuar të datës 01.01.2013 për ankuesin N.Z; Kontratën e punës për kohë të caktuar/pacaktuar të datës 02.10.2018 për ankuesen A.I ; Kontratën e punës për kohë të caktuar/pacaktuar të datës 01.04.2017 për ankuesen H.H; Kontratën e punës për kohë të caktuar/pacaktuar te datës 01.04.2018 për ankuesen E.P; Kontratën e punës për kohë të caktuar/pacaktuar të datës 03.01.2019 për ankuesen K.A; Kontratën e punës për kohë të caktuar/pacaktuar të datës 06.08.2019 për ankuesin M.ZH ; Kontratën e punës te datës 15.04.2008 për ankuesin V.M; Kontratën e punës për kohë të caktuar/pacaktuar të datës 03.01.2017 për ankuesin S.R ; Kontratën e punës për kohë të caktuar/pacaktuar të datës 03.01.2018 për ankuesen A.P ;Kontratën e punës për kohë të caktuar/pacaktuar të datës 05.06.2017 për ankuesin T.H; Kontratën e punës për kohë të caktuar/pacaktuar të datës 15.04.2019 për ankuesin I.K ; Kontratën e punës për kohë të caktuar/pacaktuar të datës 10.01.2019 për ankuesin R.K ; Kontratën e punës për kohë të caktuar/pacaktuar të datës 03.01.2019 për ankuesin T.S; Kontratën e punës për kohë të caktuar/pacaktuar të datës 01.12.2010 për ankuesin N.S ; Kontratën e punës për kohë të caktuar/pacaktuar të datës 01.04.2018 për ankuesin A.D; Akt emërimin e ankuesit H.V te datës 01.04.2014; Akt emërimin e ankueses N.G te datës 01.04.2016; Akt emërimin e ankueses M.Z te datës 29.02.2012; Akt emërimin e ankuesit R.J te datës 01.06.2016; Akt emërimin e ankueses A.B te datës 01.04.2017; Akt emërimin e ankueses F.B te datës 01.06.2018; Akt emërimin e



ankuesit F.G te datës 05.01.2016; Akt emërimit e ankueses N.H te datës 05.01.2014; Akt emërimit e ankuesit Z.Z te datës 05.01.2016; Akt emërimit e ankuesit S.G te datës 01.10.2019; Akt emërimit e ankuesit H.H te datës 01.10.2015; Akt emërimit e ankuesit L.Z te datës 29.02.2012; Akt emërimit e ankuesit R.J te datës 05.01.2016; Akt emërimit e ankuesit R.A te datës 03.01.2015; Akt emërimit e ankuesit Y.S te datës 03.01.2015; Akt emërimit e ankuesit A.I te datës 01.04.2014; Akt emërimit e ankuesit T.M te datës 03.01.2015; Akt emërimit e ankueses T.I te datës 01.08.2013; Akt emërimit e ankuesit J.G te datës 05.01.2016; Akt emërimit e ankueses D.H te datës 29.02.2012; Akt emërimit e ankueses S.P te datës 01.04.2014; Akt emërimit e ankuesit S.S te datës 05.01.2015; Akt emërimit e ankuesit N.B te datës 01.04.2015; Akt emërimit e ankueses B.S te datës 01.08.2017; Akt emërimit e ankueses V.I te datës 01.04.2015; Akt emërimit e ankueses V.Z te datës 01.08.2017; Akt emërimit e ankuesit I.C te datës 01.01.2015; Aktvendimi për caktimin e punëtorit - ankuesit I. C në vendin e punës të datës 23.06.1980; Akt emërimit e ankuesit R.M te datës 05.01.2017; Akt emërimit e ankuesit F.L te datës 01.04.2014; Akt emërimit e ankuesit M.G te datës 01.04.2017; Akt emërimit e ankuesit Naim Ismajli te datës 01.04.2014; Akt emërimit e ankuesit I.U te datës 01.02.2014; Akt emërimit e ankuesit B.SH te datës 03.04.2014; Akt emërimit e ankuesit S.Rr te datës 03.04.2014; Akt emërimit e ankuesit Rr.B te datës 05.01.2017; Akt emërimit e ankuesit A.V te datës 05.01.2016; Akt emërimit e ankuesit S.R te datës 01.07.2013; Akt emërimit e ankuesit F.B te datës 01.04.2017; Akt emërimit e ankueses Z.G te datës 03.04.2014; Akt emërimit e ankueses S.Ç te datës 05.01.2015; Akt emërimit e ankueses L.O te datës 01.04.2017; Akt emërimit e ankuesit J.S te datës 05.01.2016; Akt emërimit e ankuesit M.K te datës 19.11.2019; Akt emërimit e ankueses D.S te datës 01.04.2017; Akt emërimit e ankueses G.M te datës 05.01.2017; Akt emërimit e ankueses H.J te datës 12.07.2017; Akt emërimit e ankuesit R.F te datës 14.10.2019; Akt emërimit e ankuesit B.S te datës 01.04.2014; Akt emërimit e ankuesit XH.Ç te datës 01.04.2018; Akt emërimit e ankuesit A.A te datës 29.02.2012; Akt emërimit e ankueses A.Z te datës 01.04.2018; Akt emërimit e ankuesit Xh.LI te datës 04.04.2013; Akt emërimit e ankueses E.ZH te datës 04.01.2017; Akt emërimit e ankuesit A.A te datës 01.08.2017; Akt emërimit e ankueses M.A te datës 01.05.2019; Akt emërimit e ankuesit S.G te datës 01.08.2017; Akt emërimit e ankuesit B.V te datës 01.08.2017; Akt emërimit e ankuesit M.K te datës 01.12.2012; Akt emërimit e ankuesit A.E te datës 01.04.2015; Akt emërimit e ankuesit L.K te datës 01.06.2015; Akt emërimit e ankuesit S.H te datës 01.04.2014; Vendimin nr.03-822 te datës 06.09.2010 për R.Z; Akt emërimit e ankuesit Xh.A te datës 13.09.2018; Akt emërimit e ankuesit A.S te datës 03.04.2014; Akt emërimit e ankuesit H.M te datës 03.01.2014; Akt emërimit e ankuesit V.Sh te datës 01.04.2014; Akt emërimit e ankuesit J.B te datës 05.01.2016; Akt emërimit e ankuesit G.Sh te datës 03.01.2015; Akt emërimit e ankuesit I.H te datës 05.01.2015; Akt emërimit e ankuesit Sh.J te datës 05.01.2014; Akt emërimit e ankuesit L.A te datës 05.01.2015; Akt emërimit e ankuesit A.A te datës 27.07.2018; Akt emërimit e ankuesit V.A te datës 05.01.2015; Akt emërimit e ankuesit R.H te datës 01.01.2013; Akt emërimit e ankuesit te datës Xh.N te datës 01.07.2014; Akt emërimit e ankuesit N.S te datës 05.01.2015; Akt emërimit e ankuesit N.E te datës 01.10.2013; Akt emërimit e ankuesit M.A te datës 28.02.2013; Akt emërimit e ankuesit A.C te datës 03.01.2012; Akt emërimit e ankuesit G.G te datës 03.01.2014; Akt emërimit e ankuesit B.G te datës 03.04.2014; Akt emërimit e ankueses Sh.G te datës 05.01.2015; Akt emërimit e ankueses V.V te datës 03.01.2019; Akt emërimit e ankuesit Xh.S te



datës 03.01.2015; Kontratën e punës për kohë të caktuar/pacaktuar të datës 05.01.2018 për ankuesin S.H; Akt emërimit e ankuesit R.B te datës 01.04.2014; Akt emërimit e ankuesit R.Sh te datës 01.05.2016; Akt emërimit e ankuesit O.G te datës 01.04.2015; Akt emërimit e ankuesit E.Sh te dates 01.06.2018; Akt emërimit e ankuesit S.N te datës 13.03.2018; Akt emërimit e ankuesit F.B te datës 11.09.2019; Akt emërimit e ankueses J.H te datës 01.04.2014; Akt emërimit e ankuesit B.G te datës 01.04.2015; Akt emërimit e ankueses Sh.T te datës 03.01.2016; Akt emërimit e ankuesit I.S te datës 03.04.2014; Akt emërimit e ankueses N.H te datës 01.03.2016; Akt emërimit e ankueses N.P te datës 05.01.2016; Akt emërimit e ankuesit B.B te datës 01.04.2014; Akt emërimit e ankuesit I.D te datës 01.04.2014; Akt emërimit e ankuesit E.H te datës 01.1.02015; Akt emërimit e ankuesit I.S te datës 05.01.2015; Akt emërimit e ankuesit V.P; Akt emërimit e ankueses A.L te datës 01.09.2018; Akt emërimit e ankueses B.G te datës 01.04.2017; Akt emërimit e ankuesit N.P; Akt emërimit e ankuesit A.B te datës 01.08.2013; Akt emërimit e ankuesit S.S te datës 01.04.2014; Akt emërimit e ankuesit A.P te datës 01.10.2013; Akt emërimit e ankuesit Sh.L te datës 29.02.2012; Akt emërimit e ankuesit Sh.H te datës 29.02.2012; Akt emërimit e ankuesit F.K te datës 05.01.2016; Akt emërimit e ankuesit E.A te datës 05.01.2014; Akt emërimit e ankuesit T.S te datës 08.02.2015; Akt emërimit e ankuesit S.H te datës 05.01.2015; Akt emërimit e ankuesit E.A te datës 05.01.2014; Akt emërimit e ankuesit; Akt emërimit e ankuesit V.M te datës 01.02.2018; Listën e nëpunësve te administratës komunale ne Podujeve; Akt emërimit e ankueses F.M te datës 01.01.2015; Akt emërimit e ankuesit I.K te datës 28.02.2012; Akt emërimit e ankuesit V.A te datës 01.01.2015; Akt emërimit e ankueses V.R te datës 01.04.2015; Vendimin Nr.03-70 te datës 15.03.2018 për Sh.L; Vendimin Nr.03-70 te datës 10.01.2018 për F.G; Kontratën e punës për pune dhe detyra specifike për S.F; Vendimin Nr.03-655 te datës 29.08.201 për Sh.H; Kontratën e punës për kohë te caktuar/te pacaktuar për N.J; Kontratën e punës për kohë te caktuar/te pacaktuar për F.S; Kontratën e punës për kohë te caktuar/te pacaktuar për K.H ; Kontratën e punës për kohë te caktuar/te pacaktuar për D.K te datës 01.08.2015; Kontratën e punës për kohë te caktuar/te pacaktuar për N.S te datës 01.03.2019; Vendimin Nr-02-110/05-0063182/18 te datës 06.08.2018 për E.A; Vendim Nr-03-54 te datës 26.02.2018 për T.S; Vendim i datës 24.10.2017, 16.11.2017 për ankuesin M.B; Vendimin nr.02-112/11 te datës 17.12.2018 për ankuesin F.K; Aktvendimin C.nr.604/2019 te datës 05.11.2019 të Gjykatës Themelore ne Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil; Vendimin e datës 14.11.2017 nga MPMS për M.B; Vendimin Nr. 02.118/11 te datës 17.12.2018 për F.K; Vendim nr.02.-110/05 te datës 06.08.2018 për Vendimin me nr.13-736 te datës 24.10.2017 për M.B; Vendimin me nr.13-264 te datës 30.07.2015 për Sh.Sh; Vendimin me nr.13-711 te datës 22.09.2017 për Sh.H; Vendimin me nr.13-71 te datës 13.03.2018 për Sh.L; Vendimin me nr.13-08 te datës 10.01.2018 për F.G; Vendim me nr.13-53 te datës 26.02.2018 për T.S; Vendim me nr.02.-110/05-0053282/18 te datës 09.07.2018 për A.P; Vendimin me Nr.02.-114/020029286/22 te datës 22.04.2022 për Vendimin me Nr.02-114/02-0034564/22 te datës 17.05.2022 për Vendimin me nr.02-114 /02-00178843 te datës 10.03.2022 për S.H ;Vendim me Nr.02-114/02-0040057/21 te datës 19.05.2021 për Vendim me nr.02-181/01-0025811/20 te datës 08.06.2020 për N.S; Vendimin me Nr.02-118/02-0032054/19 te datës 15.04.2019 për ;Vendim me Nr.02-118/020070296/19 te datës 29.08.2019 për /Vendimin me Nr.02-118/02-0016358/20 te datës 02.03.2020 për Vendimin me Nr.13-104/02-0020908/20 te datës 27.04.2020 për R.L;



Vendim me Nr.02-400/01-0036222/21 te datës 05.05.2021 për Z.Z; Vendimin me Nr.02-114/02-0076489/22 te datës 06.09.2022 për M.N, Vendimin me Nr.02.-114/06-0067130/21 te datës 10.08.2021 për Vendimin me Nr.02.-120/03-0039634/22 te datës 31.05.2022 për Vendimin me Nr.02.-114/02-0108450/21 te datës 16.12.2021 për Vendimin me Nr.02.-400/01-0036225/21 te datës 05.05.2021 për E.F; Vendimin Nr.02-104/02-002055/20 te datës 06.04.2020 për Vendimin Nr.02-400/01-0036223/21 te datës 05.05.2021 për Vendimin Nr.02.114/02-010844/21 te datës 16.12.2021 për Listën e pagave për muajt prill te vitit 2022 dhe shkurt te vitit 2019; Listën e pagave për muajin dhjetor te vitit 2013, muajin nëntor te vitit 2021, muajin tetor te vitit 2021, muajin dhjetor te vitit 2021, muajin shkurt te vitit 2022, muajin maj te vitit 2022; muajin qershor te vitit 2022, muajin korrik te vitit 2022, muajin gusht te vitit 2022 dhe muajin korrik te vitit 2021; Njoftimin e datës 20.08.2020 me numër 1590/2020 nga KPMSHCK; Shkresat e datës 12.10.2021 me numër 4999/2021 si dhe te datës 05.01.2022 me numër 10/2022 lidhur me urgjencën për përshejtimin e procedurës; Kërkesën me numër 2558/2022 te datës 04.05.2022 lidhur me shqyrtimin e lëndës; Përgjigjen e datës 06.05.2022 nga KPMSHCK për përfaqësuesin e ankuesve; Autorizimin e datës 03.05.2022 nga përfaqësuesit e autorizuar, dhe për ankuesit; Revokimin e autorizimit te datës 17.08.2020; Kërkesën me numër 4456/2022 të datës 02.08.2022 nga përfaqësuesi i ankuesve; Njoftimin me numër 4490/2022 të datës 03.08.2022 nga KPMSHCK; Aktgjykimin me numër A.nr.1994/2022 të datës 06.09.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështjen Administrative; Kërkesën e datës 21.09.2022 përmes e-mailit zyrtar lidhur me provat shtesë nga KPMSHCK.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesit si në pikën **I të dispozitivit, sepse:**

Bazuar në të gjitha provat e lëndës konkretisht në Kontratat e Punës për Kohë të Caktuar/ të Pacaktuar për ankuesit si në pikën e parë I të dispozitivit të këtij vendimi, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se këta ankues mbajnë pozita si: "Vozitës", "Zjarrfikës", "Reklamues", "Roje pylli", "Punëtor teknik", "Shef brigade-zjarrfikës", "Roje objekti", "Shtëpiak".

Duke ju referuar nenit 2 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se zyrtarët publikë janë ndarë në: nëpunës të Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); nëpunës i Shërbimit Publik; nëpunës i Kabinetit; dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës, po ashtu dhe duke ju referuar detyrave të punës që kryejnë ankuesit nga pozitat e lartcekura, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se këto pozita kryejnë veprimtari ndihmëse të cilat hyjnë në kuadër të zyrtarëve publik si nëpunës administrativ dhe mbështetës siç parashihet me paragrafin 6 të nenit 2 të këtij ligji, i cili përcakton që: *"Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike"*.

Ndërlidhur me këtë pjesa VII e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka trajtuar në mënyrë të detajuar marrëdhënien e punës së nëpunësve administrativ dhe mbështetës, ku neni 82 i







Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesve për kompensimin në mënyrë retroaktive në emër të pagesës së pagës përcjellëse me rastin e pensionimit në lartësi të tri (3) pagave mujore sipas nenit 53, Shujtave të papaguara ditore për ditët e qëndrimit në punë sipas nenit 54, Pagesën e pagës së trembëdhjetë (13) në vlerën e një page bazë sipas nenit 42 paragrafi 6 si dhe pagesën e Shërbimit Jubilar sipas nenit 52, të drejta këto të njohura dhe të garantuara me Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës të datës 18.03.2014, meqenëse dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative sikurse edhe dispozitat e ligjit material dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tij nuk e kanë rregulluar çështjen e parashkrimit të kërkesave me karakter material, Kolegji i Këshillit Konstaton se organi i punësimit në këtë rast me rastin e rishqyrtimit të kësaj çështje përkatësisht kërkesave të parashtruara në këtë ankesë duhet të analizojë me kujdes dispozitat e nenit 2 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës ku përcaktohet se: *"1.Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës", "2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për të punësuarit dhe punëdhënësit, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për çështje të caktuara nga marrëdhënia e punës"*, si dhe nenin 87 të të njëjtit ligj ku përcaktohet se: *"Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës"*, andaj Kolegji i Këshillit konstaton se kërkesat e ankuesve duke marrë për bazë këto dispozita ligjore të specifikuara më lartë është e domosdoshme që lënda kthehet në ri-vendosje në Njësinë e Burimeve Njerëzore të Komunës së Podujevës, ankuesit kërkesën fillestare në lidhje me këto kërkesa e kanë bërë me 14.01.2020 në Njësinë e Burimeve Njerëzore, dhe mbi bazën e këtij fakti të analizohet baza ligjore sa i përket kësaj çështje me qëllim të vendosjes meritore në lidhje me këto kërkesa gjithnjë duke ju referuar dispozitave të legjislacionit që rregullojnë këtë çështje.

Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Podujevës me rastin e shqyrtimit dhe vendosjen lidhur me ankesën e ankuesve të datës 22.06.2020 ka bërë konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe bazës juridike, madje nuk janë lëshuar fare në shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesve, ngase me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.Prot.13-104/03-00330068/20 të datës 02.07.2020, sipas të cilit Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave e ka refuzuar ankesën e ankuesve me arsyetimin e së kërkesa e tillë nuk ka mund të gjej zbatueshmërinë për shkak të komplikimeve buxhetore në këtë institucion, po ashtu nuk i ka dhënë rëndësinë e provës përgjigjes së datës 30.01.2020 të nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Drejtori i Drejtorisë së Administratës Komunale dhe Menaxheri i Njësisë së Burimeve Njerëzore, ku të njëjtit i janë përgjigjur përfaqësuesit të palëve, ndërsa në pikën 4. *"kërkesa të tjera"* të përgjigjes në fjalë përcaktohet se, citoj: *"të gjitha të drejtat ligjore të të punësuarve do të respektohen dhe procedohen sipas afatit ligjor. (Zyra e personelit të zbatojë këtë pikë)"*, e cila për nga natyra e saj juridike nuk kishte përmbajtje refuzuese lidhur me kërkesën e ankuesve për kompensimin e pagesave të përcaktuara më Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të vitit 2015.

Andaj, në këtë kuptim Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.Prot.13-104/03-00330068/20 të datës 02.07.2020 përmes të cilit ka refuzuar ankesën e ankuesve si të pabazuar ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme



Administrative neni 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 dhe 1.6 ku përcaktohet se: *“Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:1.4. është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme”*, ngase në rastin konkret Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, diskrecionin e ka përdorur në mënyrë jo të ligjshme pasi që nuk është organ kompetent për të vlerësuar komplikimet buxhetore, si dhe arsyetimi i dhënë në vendimin e goditur përmes kësaj ankesa nuk ka arritur të arsyetojë vendimin e dhënë në kuptim të nenit 48 i të njëjtit ligj pasi që nuk ka bërë shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi, nuk iu ka referuar shkaqeve të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave, nuk e ka përcaktuar bazën ligjore të vendimit dhe arsyet konkrete me rastin e trajtimit të kësaj çështje, sikurse nuk ka specifikuar shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve, dhe si i tillë Vendimi Nr.Prot.13-104/03-00330068/20 i datës 02.07.2020 është shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kolegji i Këshillit, pas administrimit të provave të lëndës dhe shqyrtimit të tyre, analizimit të dispozitave ligjore si dhe konstatimeve të dhëna në arsyetimin e këtij vendimi ka konstatuar se është e domosdoshme që lënda të kthehet në ri-shqyrtim dhe rivendosje në Njësinë e Burimeve Njerëzore të Komunës së Podujevës, me qëllim të përcaktimit të saktë lidhur me evidentimin nga baza e tyre e administrimit të dosjeve të nëpunësive civil në kuptim llogaritjes së ditëve të punës, konstatimit të saktë të pensionimit eventual të ndonjërit nga ankuesit e kësaj ankese, konstatimin e saktë të periudhës kohore për shërbimin jubilar si dhe përcaktimit të pagës së 13 (trembëdhjetë) në kuptim të llogaritjes për secilin veç e veç të shumës së caktuar për kompensim, ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore nëse konstaton se kërkesat janë të bazuara në legjislacion në fuqi sa i përket kësaj natyre të këtyre kërkesave, me rastin e rishqyrtimit dhe ri-vendosjes duhet ta ketë parasysh që kalkulimi i këtyre beneficioneve duhet të bëhet konformë Ligjit të Punës Nr.03/L-212 përkatësisht nenit 87 ku përcaktohet se: *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*.

Ndërlidhur me shkresën zyrtare të datës 17.08.2020 për revokimin e autorizimit dhe marrjes se përfaqësimit nga ana e te autorizuarit te ankuesve z. Rafet Hasani, me kërkesën e bashkangjitur për plotësimin e listës së ankuesve, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se sipas Aktgjykimit A.nr.1994/2022 të nxjerrë me datë 06.09.2022 nga Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datën 06.09.2022 përmes të cilit e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve, duke anuluar njoftimin e datës 20.08.2020 të KPMSHCK-se dhe ka obliguar Këshillin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e ankuesve me numër A.nr.184/2020 të datës 10.07.2020, andaj Këshilli ka vendosur të shqyrtojë vetëm ankesën e ankuesve të evidentuar në ankesën e datës 10.07.2020 me listën e bashkangjitur.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, 1.6 dhe 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe



Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafin 4 dhe 5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.184/2021 e datë 10.10.2022

**Ardita Perçuku-Shyti**

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Arben MEHMETI**

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesve
- Kryetarit të Komunës së Podujevës;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.